

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar"/ Berisha me shqiptarët në New Jersey: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/berisha-me-shqiptaret-ne-amerike-diaspora-ne-shtetet-e-bas-hkuara-es-i512815
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 16:33:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 16:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5f812164aa999f1e580d2e0ba3d3429e4f4507db92014369b72be88b73c22c2d
TEKSTI	f2733949aa0a335b166b70c0ebbb4af256d1f036d07b4b0a85ec8c1cf7cb096c
PAMJA	bb84e522ae560da7b563feed785f3e827632db132324aa5fad15f1cc7ce538ba

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	66a8d2fe37a3216107b7fb34d27f8813f8c7c21203684ec10733ba5a47ca65b8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a4c534b660452ad45d6abef4c18cc65e8511af8536347f8687e7f65a9e7ea795
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmQaJPJvsr8Bbptarmn54TzLmD2ect51RUbe7VvojLdUC



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/66a8d2fe37a3216107b7fb34d27f8813f8c7c21203684ec10733ba5a47ca65b8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

E Mërkurë, 9 Shtator, 2026

- KREU
- AKTUALITET
- POLITIKE
- EKONOMI
- BOTA
- SPORT
- ART&ARGËTIM
- INSIGHTS
- EDITORIAL

- f
- @
-

Mundesuar nga

LIVE UPDATES
13 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

"Nuk shitet Shqipëria" / 99 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

"Dy kërkesa janë urgjente, dorëheqja e Ramës dhe qeveria teknike" / Protestuesi: Nesër 100-ditëshi, protestë k...

14 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

"Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar" / Berisha me shqiptarët në New Jersey: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre

Berisha nga SHBA: Nga kjo platformë kam një kushtim për të gjithë shqiptarët në botë, Shqipëria du...

16 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

Zjarret në vend/ Flakët "përprijnë" masivin pyjor në Tërbus të Pukës, rrezikohet 'kurora' e qytetit! Situata problematike edhe në Fier (PAMJET)

Vatër zjarri në kodrat e Peshkëpisë në Selenicë, era favorizon përhapjen e flakëve 6 Shtator, 16:26 ...

16 ORE ME PARE LIVE UPDATES E.d

Operacion anti-drogë në Sarandë/ Arrestohen 20 persona, mes tyre 'koka' e grupit Altin Arapi! Shisnin hashash e kokainë pranë plazheve (EMRAT+PAMJET)

Zbulohet si funksiononte skema e shitjes së drogës në Ksamil, anëtarët e grupit vinin nga Tirana dhe Elbasani vetë...

LIVE UPDATES

"Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar" / Berisha me shqiptarët në New Jersey: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre

• Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka zhvilluar një takim me shqiptarët në New Jersey. • Lideri i opozitës është pritur me brohorima në sallë nga të pranishmit. • Të shumtë në numër teksa Berisha hyri në sallë, shqiptarët u çuan në këmbë për të takuar kryedemokratin, ndërkohën brohorisnin në kor: Berisha Berisha si dhe Rama në burg! • Gjatë fjalës së tij, Berisha vlerësoi rolin e diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e cilësuar atë si një faktor të rëndësishëm në rrugëtimin demokratik të Shqipërisë dhe në mbështetjen për Kosovën. • Lideri i opozitës u shpreh se vizita e tij në SHBA i sjell kujtime të veçanta nga udhëtimi i parë në këtë vend, në mars të vitit 1991, të cilin e përshkroi si një nga udhëtimet më emocionuese të jetës së tij. • Kryedemokrati përmendi edhe takimet me diasporën shqiptare në atë periudhë, duke theksuar kontributin e saj në përmbysjen e diktaturës komuniste dhe në mbështetjen e çështjes së Kosovës. • Berisha e cilësoi diasporën shqiptare në SHBA si një nga pasuritë më të mëdha të kombit shqiptar. • Duke iu referuar ndalimit tij për të udhëtuar drejt SHBA-së, Berisha deklaroi se kjo masë ishte pjesë e një padrejtësie që nuk buronte nga vetë Shtetet e Bashkuara, por nga politika dhe agjenda që ai i cilësoi antiliri dhe antikombëtare. • Megjithatë, ai tha se vendosi të nisë një betejë për rikthimin e të drejtës së tij për të udhëtuar në SHBA. Berisha e lidhi këtë proces edhe me rikthimin e Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë pas zgjedhjeve presidenciale të nëntorit 2024. • Ai shprehu gjithashtu mirënjohje ndaj administratës së presidentit Donald Trump dhe sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, për vendimin që, sipas Berishës, i mundësoi rikthimin në SHBA. • Ai theksoi se Shqipëria po përballlet me një situatë të rëndë politike, ekonomike dhe sociale. • Berisha akuzoi qeverinë Rama për lidhje me krimin dhe kartelet e drogës, kontroll të institucioneve dhe drejtësisë, si dhe për shpopullimin e vendit. • Kryedemokrati sulmoi gjithashtu Ramën për qëndrimet ndaj Kosovës, duke e akuzuar se vepron kundër interesave kombëtare dhe në bashkëpunim me presidentin serb Aleksandar Vučić. • Ai u bëri thirrje shqiptarëve në Shqipëri dhe diasporë që të bashkohen për të rrëzuar atë që e cilësoi "narkoshtet antishqiptar", ndërsa shprehu mbështetje për autoritetet e Kosovës dhe ish-udhëheqësit e saj që ndodhen në Hagë.

5 artikuj për këtë temë.

14 ORE ME PARE

Thirrja e Berishës nga Amerika: Diaspora të bashkohet me protestën qytetare në Shqipëri që prej tre muajsh kërkon largimin e Ramës

 "Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar" / Berisha me Sali Berisha

SHBA- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, i ka bërë thirrje diasporës në SHBA që të bashkohet me protestën qytetare në Shqipëri që prej tre muajsh kërkon largimin e Ramës. Gjatë takimit me shqiptarët e Amerikës, në New Jersey, Lideri i opozitës ngriti alarmin për shpopullimin e Shqipërisë, duke deklaruar se në dekadën e fundit mbi 1 milion shqiptarë janë larguar drejt vendeve të Shengenit.

Ai e cilësoi ripopullimin e vendit si kushtin e të gjitha kushteve dhe tha se Partia Demokratike do të ndërmarrë politika për rikthimin e emigrantëve dhe mbështetjen e familjes. Berisha akuzoi gjithashtu qeverinë për keqadministrim të pasurive, korrupsion dhe dobësim të institucioneve.





"Miq, 10 vite Shqipëria ka përjetuar shokun demografik më të madh se të gjitha kohërat. Në 10 vite, 1 milion e 99 mijë shqiptarë janë larguar në zonën e Shengenit. Po të llogarisim dhe zonat e tjera, 47% e kombit ka ikur nga Shqipëria. Lëvizja e lirë sigurisht lejon njerëzit të shkojnë ku të duan, por unë ju njoftoj këtu se nga viti 2007 në vitin 2014, çdo vit, numri i shqiptarëve në Shqipëri është rritur, rritur, rritur. Ndaj dhe, ripopullimin e Shqipërisë, ne duhet ta shohim si kushtin e të gjitha kushteve, që kombi ynë, mijërvjeçar, të mos gllabërohet nga abiset e historisë. Dhe ju keni një rol të jashtëzakonshëm në këtë vend të bekuar. Keni një mundësi të madhe, me përfaqësuesit tuaj, ju më shumë se kushdo tjetër në çdo vend tjetër, mund të luani një rol parësor në këtë betejë, me të keqen në Shqipëri.

Miq, sot regjistri i gjendjes civile të shtetit tregon se lindjet janë të barabarta me ato që ishin 100 vite më parë, kur shqiptarët në Shqipëri ishin më pak se 1 milion banorë. Është koha për veprim! Është emergjencë! Rruga e rikthimit, e ripopullimit kalon nga largimi i Edi Ramës. Partia Demokratike ka një program, e cila nga themelimi i saj gjer sot, ka patur interesin e parë, interesin kombëtar, e cila vendos familjen në themel të shoqërisë, e cila në këtë situatë të krijuar dramatike, do bëjë gjithçka me ripopullimin e Shqipërisë, për ripopullimin e Shqipërisë. Do bëjë gjithçka që ju, të riktheheni në dheun tuaj. Besoj se ju jeni të bindur, se nuk ka një vend të dytë në botë, me pasuritë përrallore që kanë ato 28 mijë kilometra katrorë që ka Shqipëria. Pasuri të nivelit botëror.

Pasuri me të cilat banorët e saj mund të bëhen banorët më të prosperuar, më të pasur të rajonit dhe të Evropës. Por ato pasuri kërkojnë administrim, kërkojnë ligjin. Kërkojnë që të mos jenë mallkim për qytetarët, por të shirohen në të mira për qytetarët. Sot shqiptarët janë qytetarët më të keqpaguari në Ballkan dhe në Evropë. Në fakt, pak vite më parë, ata merrnin pensionet dhe rrogat më të larta në të gjithë rajonin. Dhe në fakt, ata sot duhet të ishin pa asnjë lloj mëdyshje, me mesataren evropiane. Por pasuritë e tyre plaçkiten, grabiten. Dhe ligji bllokohet. Imunitetet nuk hiqen, përdoren mandatet e kimit për të bllokuar prokurorin.

Të gjitha këto janë thirrje për ne. Shqipëria ka jetik vendosjen e shtetit ligjor, funksionimin e institucioneve, luftën me zero tolerancë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Prej tre muajsh, rinia dhe qytetarët e Tiranës janë angazhuar në një protestë, më të madhen që nga vitet 90. Në këtë protestë, ata kërkojnë largimin e Edi Ramës. Kërkojnë veprimin, funksionimin e institucioneve. Kërkojnë mbrojtjen e pasurive publike, dhe ai sillet si një tiran i vërtetë ndaj tyre. Ndaj dhe unë ju bëj thirrje ju, i bëj thirrje diasporës shqiptare kudo në botë, të japë kontributin e saj në këtë protestë. Partia Demokratike e mbështet fuqishëm atë," tha Berisha./Dosja.al


14 ORE ME PARE

"Beteja jonë është për Shqipërinë"/ Berisha: Kam besim se SHBA do t'i ndihmojnë shqiptarët në betejën kundër narkoshtetit

 "Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar"/ Berisha me Sali Berisha

TIRANË- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha gjatë takimit me shqiptarët në Amerikë, deklaroi se largimi i Edi Ramës nga pushteti është kushti për ripërtëritjen dhe shpëtimin e Shqipërisë. Gjatë fjalës së tij, Lideri i opozitës akuzoi qeverinë Rama për lidhje me narkotrafikun dhe e cilësoi Shqipërinë si kopsht eksperimental të ideve të George Sorosit dhe ekstremit të majtë.

Gjithashtu Berisha ngriti shqetësime edhe për politikën sociale dhe familjen shqiptare, duke theksuar se ato janë vënë në rrezik nga politika të qeverisë. Kryedemokrati tha ndër të tjera se ka besim se SHBA-të do t'i ndihmojnë shqiptarët në betejën kundër narkoshtetit.



"Nëse duam të ripërtërijmë Shqipërinë, kjo arrihet vetëm duke larguar nga pushteti Edi Ramën. Ndaj dhe unë sot kam një kërkesë për ju, këtë ditë kaq të veçantë, të na frymëzojë, ta përthithim si ditë të dinjitetit të një njeriu, si shembull për të çuar përpara betejën tonë, më të rëndësishme, shumë herë më të rëndësishme se sa këtë që festojmë sot. Betejën për dinjitetin e Shqipërisë, betejën për shpëtimin e Shqipërisë, në kushtet që është sot Shqipëria. Shumëkujt mund t'i duket e vështirë, shumëkujt mund t'i duket e frikshme, shumëkujt dhe e pamundshme. Por ashtu siç ishte e vështirë të arrinin këtë ditë, ashtu siç ishte e frikshme të arrinin këtë ditë, ashtu siç dukej e pamundur të arrinin këtë ditë, absolutisht ju jap fjalën se do të arrijmë ditën e shpëtimit të Shqipërisë.

Se do fitojmë betejën e dinjitetit kombëtar. Edi Ramën do ta largojmë nga qeveria dhe asgjë në botë nuk na ndal sot në këtë qëllim. Duke larguar Ramaduron, ne shpëtojmë Shqipërinë. Duke larguar Edi Ramën ne çlirojmë edhe një copë të Evropës. Por duke larguar Edi Ramën ne u bëjmë një shërbim të gjitha kombeve mike. Shqipëria sot është eksportues madhor droge. Miq, në ditën e pavarësisë së Shqipërisë, Sekretari Marco Rubio, për herë të parë në histori në mesazhin që dërgon, ju referohet karteleve të drogës dhe bashkëpunëtorëve të tyre si një rrezik për këtë vend të madh, si një rrezik për Shtetet e Bashkuara. Dhe vërtet çlirimi i Shqipërisë nga narkoshteti, është pra një mision, sa atdhetar, aq edhe për miqtë tanë kudo që janë.

Miq të e mi, unë jam sot këtu për të kërkuar ndihmën, mbështetjen e Shteteve të Bashkuara në këtë betejë. Në mars të vitit '91, unë erdha në këtë vend të bekuar për të kërkuar mbështetje për të përmbysur një diktaturë, diktaturën komuniste. Sot, kërkesa ime ndaj vendit që i ka dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve një ndihmë të jashtëzakonshme, ndaj këtij vendi, presidenti i së cilës udhëhoqi luftën për çlirimin e Kosovës dhe pavarësinë e saj. Kam besim të madh se shqiptarët do kenë ndihmën e tij, ndihmën e tyre, për të shpëtuar nga narkoshteti i ndërtuar në trojet e tyre. Shqipëria ka sot nevojë jetike për një ringritje, për një ripërtëritje. Shqipëria pret nga ne të rikthejmë vlerat më të arrira të shpirtit tonë, të virtyeteve tona. Sot, ju duhet ta dini, vendi juaj është kopshti eksperimental i ideve të përcudnuara të George Sorosit dhe ekstremit të majtë.

Ju duhet ta dini se në Tiranë kanë filluar t'u japin hormonet, në kundërshtim me çdo ligj dhe parim, fëmijëve 13-vjeçarë. Në tekstet, prindërit emërtohen me numra. Me një ligj të quajtur anti-diskriminim de facto i jepet goditja më fatale familjes. Po. Një ligj që nuk e ka asnjë vend në botë, përveç Shqipërisë, kopshtit eksperimental të George Sorosit. Në rrezik të madh pra është familja shqiptare. Në rrezik të madh është ajo e cila ka mbajtur kombin mbi supe në shekuj dhe mijëvjeçarë dhe së cilës ne i dedikojmë të gjithë qenien tonë. Ndaj dhe, beteja jonë është një betejë për ekzistencë të familjes shqiptare," tha Berisha./Dosja.al


15 ORE ME PARE

Berisha nga SHBA: Nga kjo platformë kam një kushtrim për të gjithë shqiptarët në botë, Shqipëria duhet të çlirohet nga narkoshteti me në krye Edi Ramën

 "Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar"/ Berisha me Sali Berisha

SHBA- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, deklaroi se Shqipëria po përballet me një situatë të rëndë politike, ekonomike dhe sociale. Gjatë takimit me shqiptarët në SHBA, Lideri i opozitës akuzoi qeverinë Rama për lidhje me krimin dhe kartelet e drogës, kontroll të institucioneve dhe drejtësisë, si dhe për shpopullimin e vendit.

Kryedemokrati sulmoi gjithashtu Ramën për qëndrimet ndaj Kosovës, duke e akuzuar se vepron kundër interesave kombëtare dhe në bashkëpunim me presidentin serb Aleksandar Vuçiç. Ai u bëri thirrje shqiptarëve në Shqipëri dhe diasporë që të bashkohen për të rrëzuar atë që e cilësoi "narkoshtet antishqiptar", ndërsa shprehu mbështetje për autoritetet e Kosovës dhe ish-udhëheqësit e saj që ndodhen në Hagë.



"Por miq, duhet të jemi të sinqertë se, këtu nuk kam ardhur vetëm për falënderime dhe festime, ndonëse mirënjohja ime ndaj jush dhe kombit amerikan është e përzetshme dhe e pakufishme. Sot unë kam ardhur këtu me një thirrje të fortë për ju, por dhe çdo shqiptar tjetër në Kanada, në Itali, në Gjermani, në Greqi, në Spanjë dhe në çdo vend tjetër të Evropës dhe të botës. Sot nga kjo platformë kam një thirrje për çdo shqiptar në Shqipëri dhe kudo që ndodhet dhe që po na ndjek në këtë takim, në media, në internet, kam një kushtrim për të gjithë shqiptarët. Dita e sotme mund të jetë për ne një moment përmbushje dhe triumfi, por ne si shqiptarë kemi disa arsye shumë të forta që sot të mos jemi të përmbushur, të mos ndjehemi të përmbushur dhe triumfues. Jo dhe jo.

Sepse Shqipëria, dheu ynë i dashur, po rrokulliset ndoshta më shumë se kurrë në ekzistencën e saj. Në Shqipëri ekstremi i majtë që ka lindur nga krimi, ka sunduar me krimin, është shartuar, është shartuar me kartelet e drogës të cilat presidenti i Shteteve të Bashkuara me shumë të drejtë po i krahason me organizatat terroriste. Duke sjellë kështu në jetë një monstër të rrezikshme që ushqehet me paratë e shqiptarëve ditë e natë, që lë spitalet pa ilaçe dhe mjeron të sëmurët shqiptarë, që ka rrënuar arsimin në një shkallë ekstreme, që ka shkatërruar drejtësinë dhe kontrollon atë, duke e bërë bashkë me dy-tre vite burg ata që kanë vjedhur miliona dhe pastaj i liron që të shijojnë paratë e tyre, siç ka ndodhur me Tahirin, Dakon, Beqajn, Çyrbjen, Bllakon e të tjerë, që janë liruar nga qelia dhe nuk u kanë kthyer shqiptarëve asnjë qindarkë të vjedhur.

Kjo monstër, duke iu referuar statistikave të Eurostatit, po kërcënon tani së fundi shqiptarët edhe me uri, me çmimet që rriten 5.2 herë më shumë të ushqimeve sesa në mesataren e Bashkimit Evropian, në qytetet që kanë kapur pagën mesatare. Kjo monstër hibride midis ekstremit të majtë dhe karteleve të drogës është narkoshteti shqiptar, me në krye Edi Ramën, i cili po shpopullon Shqipërinë me ritme apokaliptike. Ka zbrazur Shqipërinë me mbi 1 milion vetëm në zonën e Shengenit, sipas shifrave të Bashkimit Evropian. Ky narkoshtet antishqiptar është themeluar dhe drejtohet nga një individ i vetëm, që ka mbledhur të gjitha pushtetet në duart e tij, më shumë se diktatori i fundit, që sundon shqiptarët duke mos lejuar zgjedhje të lira, që ka shuar përfundimisht kufirin midis partisë dhe shtetit.

Ky monstër me emrin Edi Rama bllokoi drejtësinë me 83 mandatet e krimit, siç patë në rastin e Lubi Ballukut, ku nuk u votua heqja e saj e imunitetit. Ky monstër me emrin Edi Rama kontrollon mediat kombëtare. Dhe ky, në bashkërendim me padronin e tij në Beograd, Vuçiçin, është faktuar një armik i egër i interesit kombëtar, një armik i egër i Kosovës dhe i kombit shqiptar. Miq, Edi Rama do të ishte kryeministri i parë në botë, Tirana do të ishte qeveria e parë në botë që do të vendoste sanksione ndaj qeverisë së Kosovës, ndaj Kosovës. Do të mbetet përjetë në shtyllën e turpër, akti i këtij tradhtari i cili nuk ka përpjekje pa bërë për të plotësuar ambiciet serbe në Kosovë, për të shpërbërë Kosovën.

Por u dua të përsëhendes për zemërsisht autoritetet e Kosovës të cilat qëndruan, të cilat qëndruan. Qëndruan me burrëri, me guxim, ndaj Vuçiçit dhe argatit të tij në Tiranë. Dua të përsëhendes sot para jush dhe në emër tuaj, ish-udhëheqësit politikë të Kosovës që vuajnë vitet të tëra në burg nga projektet e këtij atdhe-shkatërruesi, dhe t'u uroj nga zemra të marrin pafajësinë dhe të kthehen të lirë në tokën e tyre. Miqtë e mi, nëse duam të shëmbim narkoshtetin antishqiptar, nëse duam të çlirojmë Shqipërinë nga këthrat e ekstremit të majtë, askush nuk duhet të harrojë: Partia Socialiste është themeluar mbi krimin kombëtar dhe tradhtinë kombëtare, ka qeverisur me krimin kombëtar, vazhdon të qeverisë me krimin kundër shqiptarëve," tha Berisha./Dosja.al

15 ORE ME PARE


"Mirënjohje presidentit Trump dhe sekretarit Rubio"/ Berisha me shqiptarët në SHBA: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre

 "Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar"/ Berisha me Sali Berisha

TIRANË- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha e ka cilësuar takimin me shqiptarët e Amerikës, në New Jersey, si një ditë të jashtëzakonshme. Lideri i opozitës theksoi se shumë shqiptarë ndër vite kanë pyetur veten nëse mund të përballen me padrejtësitë dhe forcat që i konsiderojnë shumë më të mëdha se vetja. Sipas tij, përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje është identiteti dhe qëndrueshmëria e shqiptarëve.

Duke iu referuar ndalimit tij për të udhëtuar drejt SHBA-së, Berisha deklaroi se kjo masë ishte pjesë e një padrejtësie që nuk buronte nga vetë Shtetet e Bashkuara, por nga politika dhe agjenda që ai i cilësoi antiliri dhe antikombëtare. Ai kujtoi se në atë periudhë ishte prej vitesh jashtë pushtetit dhe thuajse i tërhequr nga jeta politike.

Megjithatë, ai tha se vendosi të nisë një betejë për rikthimin e të drejtës së tij për të udhëtuar në SHBA. Berisha e lidhi këtë proces edhe me rikthimin e Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë pas zgjedhjeve presidenciale të nëntorit 2024. Ai shprehu gjithashtu mirënjohje ndaj administratës së presidentit Donald Trump dhe sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, për vendimin që, sipas Berishës, i mundësoi rikthimin në SHBA.



"Për ne sot, kjo është një ditë jo e zakonshme. Sot është një ditë që për mua përsëri ngjall emocione. Është një ditë që shumëkush e ka menduar të pamundur. E ka menduar si një ditë që nuk do ta shihnim ndonjëherë. Sepse, le të jemi të sinqertë, shumë prej nesh të paktën një herë ose më shumë kemi pyetur veten: kush jemi ne? Kush jemi ne për të sfiduar një padrejtësi, kur ajo padrejtësi bëhet nga forca shumëfish më të mëdha se ne. Jo pak herë kemi pyetur veten këto vite, kush jemi ne, që zëri ynë i të drejtës të dëgjohet në një botë ku për fat të keq gjithmonë e më shumë po sundohet nga e padrejta. Kush jemi ne që të qëndrojmë të fortë kur në momente të caktuara e gjithë bota duke kundër nesh. Këto janë pyetje që vërtet të bëjnë të ndihesh i vogël në një botë të madhe.

Këto janë pyetje që të bëjnë të ndihesh i pafuqishëm përballë padrejtësive shumë të fuqishme. Por kjo pyetje, kush jemi ne, ka një përgjigje, e cila përjetësisht do jetë, do jetë burim i pashtershëm i fuqisë sonë për të bërë të pamundurën të mundur. Ne jemi shqiptarë! Sepse ne jemi shqiptarë dhe qëndrojmë e luftojmë të pamposhtur për dinjitetin tonë. Sepse ne jemi shqiptarë, luftojmë dhe qëndrojmë të vendosur për familjet tona. Ne jemi shqiptarë, ndaj dhe luftojmë në kushtet më të pabarabarta për kombin tonë, dinjitetin dhe lirinë e tij. Ne jemi shqiptarë, ndaj dhe nuk dorëzohemi. Prandaj ditë si kjo, të pamundura ne i bëjmë të mundura. Zoti ju bekoftë!

Kjo ditë shënon pra një nga ato raste, forcë e të keqes që të gjithë e njohim në një agresion të padrejtë ndaj dinjitetit tim, më mohoi hyrjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 4 vite më parë.

Në një kohë kur unë isha, 8 vite pa asnjë pushtet, thuajse i tërhequr plotësisht nga jeta politike. Por, me fuqinë që na karakterizon ne si shqiptarë, me besimin e palëkundur tek Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vlerat mbi të cilat është ndërtuar ky vend e komb i madh, vend i të lirëve, shtëpi e guximtarëve. I qartë si kristali se kjo padrejtësi nuk po vinte nga Shtetet e Bashkuara, por po vinte nga axhendat antiliri, antikomb, të asaj që vetë presidenti Donald Trump e ka emërtuar si ekstremi i majtë. Duke mbajtur në mend shprehjen e një prej burrave më të ndritur dhe legjendarë të kombit të madh amerikan, Abraham Lincoln, i cili thotë se 'rëndësi nuk ka sa herë rrezohesh, por sa herë ngrihesh'. Dhe unë, dhe unë vendosa të ringrihem. Vërtet e nisa këtë betejë në pamje të parë në pamundësi të plotë.

Në errësirë. Por asnjë natë, asnjë natë nuk zgjat dot pafundësisht. Në të njëjtën kohë që unë zhvillova këtë betejë, populli i madh amerikan vendosi të ringrihet duke zgjedhur si president Donald Trump në nëntor të vitit 2024. Pak nga pak, bota e lirë filloi të ringrihet nga agresioni i ekstremit të majtë, dhe efektet erdhën deri në Shqipëri. Ata që na treguan ne barin, përfunduan të papunë. Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata vetë në vendin e tyre. Ata që përgatitën mashttrimet ndaj meje në Shqipëri, sot janë prapa hekurave, ndërsa unë sot po qëndroj me dy këmbë mbi atë tokë që ata mendonin të ma ndalonin përgjithmonë. Ndaj dhe unë sot, kam një mirënjohje të pakufishme ndaj jush, burra, gra, djem dhe vajza, shqiptarë të vërtetë që më mbështetët në orët më të para por dhe ndër më të vështirat. Mirënjohje të pakufishme ndaj administratës së presidentit Donald Trump, sekretarit të Departamentit të Shtetit, Marco Rubio, për vendimin e tij," tha Berisha./Dosja.al

15 ORE ME PARE

Berisha me shqiptarët në Amerikë: Diaspora në Shtetet e Bashkuara është fati i bardhë, fati i mirë i kombit shqiptar

"Diaspora në SHBA, fat i mirë i kombit shqiptar" / Berisha me
Sali Berisha

SHBA- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka vlerësuar rolin e diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e cilësuar atë si një faktor të rëndësishëm në rrugëtimin demokratik të Shqipërisë dhe në mbështetjen për Kosovën.

Gjatë takimit tij me shqiptarët e Amerikës, në New Jersey, Lideri i opozitës u shpreh se vizita e tij në SHBA i sjell kujtime të veçanta nga udhëtimi i parë në këtë vend, në mars të vitit 1991, të cilin e përshkroi si një nga udhëtimet më emocionuese të jetës së tij.

Kryedemokrati përmendi edhe takimet me diasporën shqiptare në atë periudhë, duke theksuar kontributin e saj në përmbyshjen e diktaturës komuniste dhe në mbështetjen e çështjes së Kosovës. Berisha e cilësoi diasporën shqiptare në SHBA si një nga pasuritë më të mëdha të kombit shqiptar.



"Të dashur vëllezër, miq, zonja, zotërinj shqiptaro-amerikanë. Përshëndetjet e mia më të përzemërta, mirënjohjen më të pakuftshme për këtë pritje vëllazërore. Kënaqësi më të madhe që unë takohem sot me ju. Me të njëjtin besim që kam patur në mars të vitit 1991 në udhëtimin tim të parë në këtë vend të bekuar. Ai ishte një udhëtim më emocional në jetën time. Emocionet vërshonin nga kënaqësia se unë po udhëtoja në drejtimin e duhur, pas dekadash që vendi im kishte humbur drejtimin. Kënaqësia ime e jashtëzakonshme ishte se po takoja ju, zërin e pamposhtur i shqiptarëve në liri. Ndaj dhe unë sot, e konsideroj vizitën time tek ju, te pasardhësit e atyre, si një dhuratë të vyer. Fati i madh imi se takova atë plejadë të diasporës shqiptare e cila me atdhetarinë e saj, me idealet demokratike, me idealet kombëtare, dha një kontribut të jashtëzakonshëm në përmbysjen e diktaturës komuniste në Shqipëri dhe luftoi me të gjitha mjetet për lirinë e Kosovës. Diaspora shqiptare në Shtetet e Bashkuara është fati i bardhë, fati i mirë i kombit shqiptar," tha Berisha./Dosja.al

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.